



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 149, datë 6.3.2025

P Ë R

MIRATIMIN E ZONAVE KADASTRALE NË TË CILAT LEJOHET
KULTIVIMI I BIMËS SË *CANNABIS*-IT PËR QËLLIME
INDUSTRIALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 12, të ligjit nr.61/2023, “Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e zonave kadastrale në të cilat lejohet kultivimi i bimës së *cannabis*-it për qëllime industriale, sipas shtojcave, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.
2. Ushtrimin e aktivitetit të kultivimit të bimës së *cannabis*-it për qëllime industriale, në përputhje me kufizimet e përcaktuara në vendimin nr.50, datë 22.1.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e standardeve për zonat dhe parcelat e tokës në të cilat do të lejohet kultivimi i bimës së *cannabis*-it për qëllime mjekësore dhe industriale”.
3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme, Agjencia

Kombëtare e Kontrollit të *Cannabis*-it dhe subjektet e lejuara për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

BELINDA BALLUKU

**MINISTRI I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL**

ANILA DENAJ